



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 15.1.2024

Nr: 7

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS  
SHUMEMËRORE TË "PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË", QARKU TIRANË, Z. PLARENT  
PJETËR NDRECA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat "i", "n" e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe të Kreut V, të vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

**VËREJ:**

Me shkresën nr. 43 prot., datë 8.1.2024, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e mungesës pa arsye për mbi 6 muaj rresht në Kuvend, të deputetit z. Arben Nevruz Ahmetaj, i zgjedhur në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, propozuar nga "Partia Socialiste e Shqipërisë".

"Partia Socialiste e Shqipërisë", është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 69, datë 15.2.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të zhvilluara në datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 409, datë 23.6.2021, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirënditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën

Data: 15.1.2024 Nr: 7  
Ora: 11:00



"Për dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të radhës në listen shumëmemërore të "Partisë Socialiste të Shqipërisë", në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë z. Plarent Pjetër Ndreca".

zgjedhore, Qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi, “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021, ka fituar 18 (tetëmbëdhjetë) mandate.

Rezulton se lista shumemërore e “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 409, datë 23.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të cilin është miratuar rirënditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 22 (njëzet e dy), z. Plarent Pjetër Ndreca.

Me shkresën nr. 92 prot, datë 12.1.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për deputet, të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, z. Plarent Pjetër Ndreca, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Plarent Pjetër Ndreca, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër TR-PS-38601/1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile si dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, për z. Plarent Pjetër Ndreca, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Plarent Pjetër Ndreca.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike

ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Plarent Pjetër Ndreca, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Plarent Pjetër Ndreca, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Arben Nevruz Ahmetaj, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë i renditur me numër rendor 22 (njëzet e dy), z. Plarent Pjetër Ndreca.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Kreun V, të vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

### **VENDOS:**

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, z. Plarent Pjetër Ndreca.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**